



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Histori Gjuhe (B)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare
Viti / Semestri : Viti III ,semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo është një lëndë e detyrueshme dhe me karakter historik - kronologjik, që do t'i japë studentit një formim rreth Çështjes së gjuhës italiane. Shekull pas shekulli studentët do të njihen me teoritë kryesore rreth gjuhës italiane, këndvështrimet e ndryshme nga të cilat është analizuar gjuha; fillimet e çështjes së gjuhës italiane, analizën e saj nga Dante në *De Volgari eloquentia*, etj. Në këtë lëndë studenti do të krijojë aftësinë për të zhvilluar kompetencën e arësytimit, argumentimit dhe sistemimit të njohurive si nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së punimeve dhe projekteve përgjatë kursit;

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjithë faktorët dhe elenemtet që kanë ndikuar në zhvillimin e gjuhës italiane; historinë e teorive kryesore nga Dante e deri në ditët e sotme.
- 2.Të jetë i aftë të identifikojë dhe veçojë elementët kryesorë në çështjen e gjuhës italiane, konceptet dhe format themelore të zhvillimit të gjuhës; të analizojë mendimin kritik të studiuesve të saj; të realizojë një punim duke u nisur nga elementë të përgjithshëm për të arritur tek detaji që duam të analizojmë.
3. Të jetë i aftës për të zgjedhur tema kërkimore shkencore që mund të ngjallin debate mbi çështjen e gjuhës italiane; të punuarit në mënyrë të pavarur dhe me iniciativë.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Të jetë i aftë për të komunikuar me gojë dhe me shkrim si dhe njohja e terminologjisë bazë së çështjes së gjuhës italiane
- 2.Të jetë i aftë për të kërkuar dhe administruar informacionin në internet;
- 3.Të jetë i aftë për nxitjen e punës në grup dhe sensibilizimi për temat sociale. Kompromisi me etikën si dhe me përgjegjësinë qytetare e profesionale.;
- 4.Të jetë i aftë për të njohur proceset e zhvillimit të gjuhës, të plurikulturalizmit, ndërkulturalizmit dhe diversitetit kulturor;